



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.43/2019

Prishtinë, më 4 shkurt 2019

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Shemsi Syla, Fisnik Ismaili, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavleviq, Mirjeta Kalludra dhe Mexhide Mjaku-Topalli.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Minire Begaj, Feride Podvorica, Shpend Haxhibeqiri, Leonora Selmanaj dhe Nazmije Kajtazi – anëtarë të Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Takim në Komisionin FunkSIONAL, me përfaqësues të Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
3. Të ndryshme.

\*\*\*

- 1. Takim në Komisionin FunkSIONAL me përfaqësues të Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës;**

Duda Balje, kryetare, falënderoi për praninë e anëtareve të Komisionit, dhe mediat duke shtuar se kjo mbledhje për shkak që ka të bëjë me çështje të ndjeshme dhe se duhet të ketë konfidencialitetin e vet, duhet të mbahet me dyer të mbyllura. Ndërsa, në fund të takimit do të deklarohemi edhe para mediave, në lidhje me ecurinë e kësaj mbledhjeje.

Minire Begaj, tha se në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë këtë fushë si dhe në pajtim me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme, Komisioni brenda kompetencave të tij, shqyrton aplikacionet dhe dokumentet e nevojshme, të cilat shërbejnë si prova lidhur me statusin e viktimës së dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe merr vendim për njohjen apo refuzimin e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës.

Nga 911 aplikacionet e pranuar deri më tani, Komisioni ka shqyrtuar dhe vendosur si në vijim:

- 195 personave u është njohur statusi viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës;
- 123 personave u është refuzuar statusi viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës;
- Janë pranuar 100 kërkesa për rishqyrtim, prej të cilave, për 46 kërkesa është vendosur (16 njohje të statusit dhe 27 refuzime të statusit),
- 54 kërkesa për rishqyrtim janë në trajnim në Komision, dhe
- Rreth 50 aplikacione të reja janë në shqyrtim e sipër.

Marrë parasysh këtë, Komisioni deri më tani ka vendosur përfundimisht për 318 aplikacione, si dhe më shumë se 100 aplikacione janë në procedurë të shqyrtimit (54 raste me kërkesë për rishqyrtim dhe rreth 50 aplikacione reja).

Në kuadër të kësaj, dhe me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të ligjshëm, si dhe për shkak të kompleksitetit dhe ndjeshmërisë së çështjes, Komisioni për vendosjen e rasteve të lartpërmendura, përkatësisht për vendosjen për një rast ka mbajtur nga 1-5 shqyrtime, përfshirë këtu edhe në rastet e nevojshme në panel intervistues.

Andaj, si rrjedhojë dhe marrë mesataren e shqyrtimeve, Komisioni për periudhën prej 5 shkurt 2018, e deri më tani, ka mbajtur rreth 1 (njëmijë) shqyrtime lidhur me aplikacionet e parashtruara.

Teuta Haxhiu, pyeti për një rast i cili ka aplikuar në muajin mars të vitit të kaluar dhe deri tani nuk kanë marrë asnjë përgjigjeje. Ajo u interesua nëse aplikuesit njoftohen për procedurën e lëndës qoftë edhe për refuzim.

Minire Begaj, tha se si rregull Komisioni përmes sekretarisë, pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar, njoftohet nga përfaqësuesi i asaj shoqate përmes së cilës ka aplikuar, apo palës së autorizuar, që pala e ka angazhuar, pra nga mënyra se si ka aplikuar edhe njoftohet. Lëndët e marsit, tha se janë shqyrtuar dhe se janë në shqyrtim lëndët e muajit prill.

Duda Balje, pyeti sa kohë merr shqyrtimi i një rasti prej momentit të aplikimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar, sepse ankesat tek ne kanë qenë pikërisht për vonesa në kohën e shqyrtimit të Komisionit. Ankesat shkojnë në drejtim të Komisionit, e jo shoqatës.

Minire Begaj, tha se shumica e lëndëve marrin kohë 3-5 herë për t'i shqyrtuar.

Feride Podvorica, tha se si Komision funksionojnë në kushte jo të mira për punë. Tash e një vit nuk janë vizituar nga asnjë institucion shtetëror. Pajisjet e punës nuk kanë qenë funksionale në shtator të vitit të kaluar UN Women, ju ka siguruar një laptop, kurse deri atëherë kishin një laptop pa tastaturë. Inventari është me defekte të mëdha, sipas detyrës zyrtare ftojmë edhe palët

në panel intervistues dhe kur vjen pala nuk kemi pasur as ujë me ju ofruar, edhe këtë e kemi siguruar vetë. Kemi mbajtur 6-8 takime në muaj, në orar të punës, jashtë orarit kemi punuar edhe gjatë vikendit, dhe me shumë kemi bërë një punë humane. Për mbajtjen e takimeve, tha se janë procesverbalet të cilat janë konfidenciale. Punojnë në bazë të ligjit, rregullores dhe në bazë të Ligjit për procedurë administrative, sepse zhvillojnë procedurë administrative, ngase kanë përgjegjësi ligjore dhe morale.

Ajo foli për ecurinë e procedurës që zhvillojnë në Komision, kurse më pas njoftoi se kanë filluar që disa raste ti paraqesin edhe në Prokurori sepse sipas Kodit Penal të Kosovës, jemi të obliguar të mos fshehim vepra penale. Arsyeja pse vonohet një rast, është ajo që ti japim mundësi një aplikuesi që të ofrojë dëshmi, në mënyrë të drejtë.

Fisnik Ismaili, tha pse për kushtet jo të mira të punës që si Komision ballafaqoheni, po informohemi pas një viti. Pse nuk jemi informuar për këtë? Duhet të informohemi, që ekziston problemi për të evituar problemet, sepse vendimet që i merrni ju në ato kushte mund të kenë të meta, sepse ndikon ambienti dhe kushtet e punës. Ai shprehu brengën rreth rasteve të refuzimit të rasteve të ankesave, dhe në çka i bazoni dëshmitë, sepse 20 vite pas luftës, është e vështirë të bazoheni në dëshmi.

Saranda Bogujevci, lidhur me kushtet e funksionimit të Komisionit qeveritar, tha se këtu jemi për me i shty proceset përpara dhe t'ju ndihmojmë. Nëse rregullorja nuk i përmbush kërkesat që ju të funksiononi si komision, edhe këtu duhet të jenë kërkesat për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores. Si anëtarë të këtij komisioni, duhet ta keni punën e komisionit, punë parësore. Është shqetësuese që ende nuk kemi një raport me shkrim, lidhur me punën e këtij komisioni.

Luljeta Veselaj-Gutaj, në lidhje me kushtet që funksionon ky Komision, po dëgjojmë për herë të parë. Nuk kanë pasur mundësi ta ngrehin zërin për këtë, por edhe të bëjnë presion në Qeveri, që të sigurohen kushtet përkatëse për trajtimin e një çështje tejet të ndjeshme. Ajo pyeti, nëse është bërë kërkesë, që një ditë të caktuar, qoftë në javë, qoftë në muaj, ekskluzivisht të merreni vetëm me shqyrtimin e aplikacioneve.

Shemsi Syla, pyeti se sa anëtarë ka ky Komision dhe se përveç kësaj pune, anëtarët e këtij Komisioni, a punojnë edhe punë tjetër? Sa i përket kushteve, a ju keni kërkuar nga Qeveria plotësimin e kushteve dhe çfarë mund t'ju ndihmojë Komisioni, që ju të jeni në nivelin e detyrës. Është mirë kërkesat e juaja t'i adresoni me shkrim. Shumë shpejt do të bëjmë një vizitë për të parë kushtet në të cilat punoni.

Veton Berisha, tha se për këtë proces a jeni duke marr shembuj të vendeve të cilat kanë pasur përvoja të njëjta si Bosnja apo Kroacia, se si i kanë trajtuar këto raste, dhe vlerësimet që i bëni, nuk duhet të jenë të ngutshme. Komuniteti të cilit i përket, e din që është duke ndodhur një proces i tillë, por nga informatat që i ka deri tani, asnjë nuk ka marrë guximin të paraqitet në këtë Komision.

Berisha, pyeti se si Komision a keni të drejtë të bëni fushatë, qoftë edhe përmes OJQ-ve, që këta persona që kanë përjetuar dhunë, të aplikojnë, pra për të bërë një sensibilizim se ky proces është i drejtë, ligjor dhe të gjithë ata që kanë përjetuar dhunë të trajtohen ashtu siç e meritojnë.

Minire Begaj, tha se në asnjë moment kushtet jo të mira që i kemi pasur, nuk kanë ndikuar në objektivitet dhe në marrjen e vendimeve. Secilën storie me disa faqe, e lexojmë me zë.

Sipas ligjit e kemi obligim njëherë në vit, t'i raportojmë Qeverisë, respektivisht Zyrës së Kryeministrit, e ne këtë e bëjmë çdo tre muaj.

Shpend Haxhibeqiri, tha se ka raste që nuk paraqiten për arsye sepse e kanë krijuar një stabilitet familjar dhe emocional. Paraqitja, apo mosparaqitja është e drejte e tyre.

Ai sqaroi punën e intervistimit dhe marrjes së dëshmime në panel si dhe paraqitjen e fakteve nga ana e palëve dhe procedurën deri te marrja e vendimit.

Minire Begaj, tha se në statistikë e kemi të evidentuar që me një lëndë, jemi marrë deri në 7 herë.

Fisnik Ismaili, tha se çka mund të bëjmë, në mënyrë që t'i i nxisim këto gra të aplikojnë, për atë se çka ju takon, sepse më e vogla çka ne mund t'jua japim, është ajo çka ju takon, dhe cili është problemi që po i ndalon gratë që të aplikojnë.

Feride Podvorica, tha se me ligj, viktimat i kanë 5 vite kohë për të aplikuar, me mundësi të vazhdimit për vite të tjera, deri sa ka nevojë, dhe kjo lë hapësirë që mos të paraqiten me numër të madh qysh në vitin e parë.

Duda Balje, kryetare, tha se pas të gjithë kësaj që dëgjuam, duhet t'i dërgoni në formë të shkruar kërkesat e juaja, në lidhje me kushtet, sepse kemi mundësi të bëjmë presion që kushtet e juaja të përmirësohen, ngase kjo ka ndikim edhe në punën që ju bëni.

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara**

Nënkryetarja e Komisionit konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 19 dhjetor të viti 2018 dhe 22 janar 2019, u miratuan pa vërejtje.

## **3. Të ndryshme.**

Nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Kryetarja e Komisionit,

---

Duda Balje